



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**

Tiranë, më 18.9.2018

Dokument parlamentar

(Komision përgjegjës)

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT OPEC PËR ZHVILLIM
NDËRKOMBËTAR (OFID), PËR PROJEKTIN E PUNIMEVE PËR RIPARIME
EMERGJENTE TË AUTOSTRADËS TIRANË-ELBASAN”**

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 11 shtator 2018, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID), për projektin e punimeve për riparime emergjente të Autostradës Tiranë-Elbasan”, propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit përgjegjës, sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë sqarimet përkatëse, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Zëvendësministri i Financave, si dhe përfaqësues të tjerë të këtyre ministrive.

II. Përmbajtja e projektligjit.

Marrëveshja është nënshkruar nga palët më 29.8.2018. Ajo parashikon marrjen, nga Fondi OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar, të një huaje prej 16 milionë dollarësh, e cila do të përdoret për financimin e projektit për riparimin emergjent të punimeve civile në segmentin rrugor nr.1 Sauk-hyrje, Tuneli i Kërrabës. Ky segment rrugor është pjesë e Autostradës Tiranë-Elbasan.

Ky financim u bë i nevojshëm gjatë zbatimit të projektit, ku u vërejtën probleme gjeologjike në disa zona, siç janë rrëshqitjet në zonën e Ibës dhe lëvizjet gjeotektonike në zonën e Mulletit. Këto probleme gjeologjike ishin pasojë e humbjes së qëndrueshmërisë së shpateve rrugore.

Për të zgjidhur këto probleme, u hartua e miratua ky projekt, i cili ka qëllim reduktimin e aksidenteve apo rreziqeve gjeologjike përgjatë segmentit 1 të Autostradës Tiranë-Elbasan, duke pëmirësuar qëndrueshmërinë e përgjithshme operacionale të saj, si dhe duke eliminuar rreziqet e sigurisë dhe mbylljet e rrugës për shkak të rrëshqitjeve të tokës.

Termat e huasë prej 16 milionë USD janë:

- Interesi (normë vjetore): 2.75 për qind;
- Tarifa e shërbimit: 1 për qind normë vjetore, që aplikohet mbi shumën e disbursuar dhe të pashlyer të huasë;
- Maturimi 20 vjet, duke përfshirë periudhën prej 5 vjetësh pa pagesë principali.

Afati i përdorimit të kësaj huaje është deri më 31 dhjetor 2019.

III. Vlerësimi i Komisionit.

Së pari, Komisioni e konsideron marrëveshjen me Fondin OPEC me rëndësi të veçantë, pasi nëpërmjet saj sigurohet financimi i nevojshëm për kryerjen e riparimeve në disa zona të Autostradës Tiranë-Elbasan, duke e përfunduar dhe vënë në funksionim të plotë këtë segment rrugor që lidh lindjen me perëndimin. Zbatimi i këtij projekti do të sjellë lehtësimin e trafikut; reduktimin e kostos operative të automjeteve, të aksidenteve rrugore dhe të kohës së udhëtimit; si dhe sigurimin e një lidhjeje më të shpejtë me zonat bregdetare, malore e rurale. Gjithashtu, ky projekt do të krijojë lidhje të rëndësishme me Maqedoninë e Greqinë. Kjo do të ndihmojë në zgjerimin e aktiviteteve tregtare, tranzitit dhe turizmit në vendin tonë. Kredia është me terma të buta dhe është shumë e leverdisshme për vendin.

Së dyti, Komisioni mbështeti kërkesën e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, që ligji të hyjë në fuqi menjëherë, me qëllim fillimin e punimeve sa më parë, në kushtet e favorshme atmosferike dhe përfundimin e veprës brenda këtij viti.

Së treti, Komisioni thekson se duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje mbikëqyrjes së punimeve të këtij projekti, për të evituar fenomenet që kanë ndodhur më parë në ndërtimin e kësaj autostrade, siç janë moszbatimi i kontratës së punimeve civile apo keqmenaxhimi i fondeve, i cili ka sjellë dëm ekonomik në buxhetin e shtetit.

Së katërti, pas përfundimit të punimeve në këtë segment rrugor, por edhe në të gjithë sistemin rrugor, duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë mirëmbajtjes së tyre, duke krijuar mundësinë për të pasur rrugë cilësore e të sigurta për lëvizjen e qytetarëve dhe mallrave.

Së pesti, për mirëmbajtjen e rrugëve, krahas fondeve të buxhetit të shtetit, në raste të caktuara lind nevoja e dhënies së kontributit nga qytetarët, si përdorues të tyre. Kjo është një praktikë e përdorur gjerësisht edhe në vende të tjera. Në këto raste është e nevojshme të kryhen fushata sensibilizimi për të informuar qytetarët mbi këtë proces në të cilin ata përfshihen. Krahas kësaj, strukturat kompetente ekzekutive duhet të kryejnë studime dhe të sigurojnë mbështetje për qytetarët që nuk kanë burime të mjaftueshme për kryerjen e këtyre pagesave, duke i krijuar mundësi çdo personi të përdorë rrjetin tonë rrugor.

Së gjashti, në hartimin e kontratave për ndërtimin apo kryerjen e punimeve në rrugë, me fondet e buxhetit të shtetit apo me partneritet publik privat, duhet të respektohen me rigorozitet rregullat e prokurimit publik, duke garantuar transparencë maksimale të procesit dhe garë konkurruese, për të bërë të mundur përzgjedhjen e fituesit që ofron çmimin dhe cilësinë më të mirë të punimeve.

Së shtati, Komisioni i bën apel Prokurorisë së Përgjithshme që të përshpejtojë hetimin dhe dërgimin në gjykatë të çështjeve të kallzuara penalisht për ndërtimin e Autostradës Tiranë-Elbasan, me qëllim shlyerjen e dëmeve ndaj buxhetit të shtetit dhe dënimin e personave përgjegjës.

IV. Përfundim.

Mbështetur në argumentet dhe vlerësimin si më lart, Komisioni e miratoi projektligjin me të gjitha votat e deputetëve të pranishëm në mbledhje. Pas dhënies së pëlqimit nga Presidenti i Republikës për hyrjen në fuqi të ligjit, në përputhje me nenin 84 pika 4 të Kushtetutës, Komisioni propozon që në nenin 2 të projektligjit hyrja në fuqi të bëhet menjëherë.

RELATORJA
Evis KUSHI

KRYETARI
Erion BRAÇE